



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “Shkenca Shoqërore,Ekonomike,Juridike,Natyrës, IT” niveli
minimal i diplomës “Bachelor ”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar , si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18/03/2015, **Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Delvine** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

☒ 1 (një) Specialist Statistike – kategoria e pages IV -3;

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIMIN NE SHERBIMIN
CIVIL NE KATEGORINE EKZEKUTIVE) APLIKOHET NE TE NJEJTEN
KOHE**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
LËVIZJE PARALELE:**

16 Korrik 2026

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:**

21 Korrik 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Harton regjistrin e statistikave .
2. Përditson të dhënat statistikore duke rakorduar punën me drejtorit , sektorët, zyrat e institucione të ndryshme .
3. Menaxhon dhe grumbullon të dhënat në përputhje me objektivat kryesore të punës duke synuar realizimin në kohë të planeve të përcaktuara në projektet prioritare të Bashkisë;
4. Grumbullon në mënyrë periodike (3, 6, 9 dhe 12 mujore) dhe përpunon, duke i shoqëruar edhe me paraqitjet grafike përkatëse, të dhënat statistikore të fushave të ndryshme nga drejtoritë e Bashkisë, ndërmarrjet në varësi të saj dhe institucione të tjera;
5. Përzgjedh dhe përgatit materiale statistikore të përditësuara të cilat shërbejnë për faqen zyrtare të internetit të Bashkisë si dhe për qëllime të tjera;
6. Planifikon dhe menaxhon njohjen e teknikave dhe përvetësimin e tyre, si edhe të gjitha burimet e tjera të vëna në dispozicion për realizimin në kohë dhe me efektivitet të procesit të punës; - Përgatit dokumenta dhe të dhëna të nevojshme statistikore të përfshira në programin e statistikave zyrtare, në mënyrë të përditësuar për INSTAT;
7. Krijon dhe mban kontakte të vazhdueshme me zyrat analoge, pranë institucioneve të tjera (INSTAT, Ministri, Institute Shkencore e Kulturore), organizma të huaj e subjekte private, me qëllim marrjen dhe dhënien e informacionit statistikor në funksion të punës së drejtorisë dhe bashkisë;
8. Drejton dhe analizon procesin e realizimit të përpunimit të treguesve statistikorë duke ndikuar në përmirësimin dhe ecjen përpara të procesit në fushën e analizës statistikore

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- d) Te zoteroje diplome te nivelit “ **Bachelor** “ ne **Shkencat Shoqërore , Ekonomike , Juridike , Natyrës, TIK**”

Tjetër:

- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar (bashkalidhur dhe diploma bachelor)

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f-Vetedeklarimin e gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.07.2026.

Bashkia Delvine

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Lagjia "Sinan Ballaci "

Rruga "Nazif Haderi "

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19-07-2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stenden e Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore" ..
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.

- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike” i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Njohuritë mbi Ligjin 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative”.
- Njohuri mbi Ligjin 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen për përvojën ,trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën , si dhe certifikimet pozitive .Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me :

- a- Njohurite , aftesite , kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes ;
- b- Eksperiençen e tyre te meparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren .

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpallje fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive,informacion qe do ta merni ne faqen zyrtare “Sherbimit Kombetar te Punesimit “duke filluar nga data 19.07.2026.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët

plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotësi për te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhën shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete në kushte shëndetsore që lejojnë të kyeje detyrën teknike perkatese;
- e) Te mos jete i denuar me vendim të formës së prirë për të kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jete marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil , që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nepunësin civil “ i ndryshuar .

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

d) Te zoteroje diplome të nivelit “ **Bachelor** “ në shkencat **Shoqërore , Ekonomike , Juridike , Natyrës, TIK**”

Tjetër:

- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjëni në linkun:

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar (përfshirë edhe diplomën bachelor);

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 21.07.2026 në adresën:

Bashkia Delvine

Lagjia “Sinan Ballaci “

Rruga “Nazif Haderi”

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.08.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e Bashkisë Delvine listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvine , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 “Për vetqeverisjes vendore” ..
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike” i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Njohuritë mbi Ligjin 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative”.
- Njohuri mbi Ligjin 17/2018 “Pwr statistikat zyrtare”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervisten e strukturuar me goje qe konstiton ne motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrieren , deri ne 25 pike.
- c- Jeteshkrimin , qe konstiton ne vleresimin e arsimimit te pervojës e te trajnimeve , te lidhura me fushen, deri ne 15 pike.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stenden e Bashkise Delvine . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit ne portalin “Sherbimi Kombetar i Punesimit “ si dhe ne stendat e Bashkise Delvine :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Sherbimit Kombetar te Punesimit “ duke filluar nga data 03.08.2026.